

VENDIM
Nr. 360, datë 11.6.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 419, DATË 15.5.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 6, shkronjat “a”, “b”, “d”, “e”, dhe 7, pika 1, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, dhe të neneve 17 e 18 të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 419, datë 15.5.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u jep ndihmë financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, deri në 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë, por në asnjë rast më shumë se 70% të kostove të pranueshme. Në kostot e pranueshme që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot për:

a) përshtatje produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të menaxhimit të cilësisë;

b) pjesëmarrje në panairë jashtë vendit;

c) krijim faqeje interneti, zhvillim të tregtisë elektronike dhe promovim, publikim dhe hartim materialesh promovuese;

ç) shërbime këshillimore. Në këtë rast kostot që mund të bashkëfinancohen nuk mund të jenë më shumë se 50 % e koston totale të këtyre shërbimeve.”.

2. Në shkronjën “a” të pikës 3 hiqen fjalët “... dhe që gjatë procesit i japin një vlerë të shtuar të konsiderueshme produktit përfundimtar ...”.

3. Në shkronjën “b” të pikës 3 hiqen fjalët “... për zgjerimin e eksporteve ...”.

4. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë të zbatohet për një periudhë 3-vjeçare, gjatë viteve 2013 dhe 2014, me një vlerë prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh për secilin vit, ndërsa për vitin 2015, me një vlerë prej 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekësh.”.

5. Kudo në vendim emërtimi “Ministri/a i/e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me “Ministri/a përgjegjës/e për ekonominë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama